



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:000210

Datë: 30.03.2022

Numri i dokumentit: 02860074

P.nr.64/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

DIVIZIONI PENAL Sipas gjyqtarit Refki Piraj, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Halime

Nixha, në lëndën penale kundër të pandehurit A.I. nga Prizren, me numër personal për shkak

te veprave penale: Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nenpar.3.1 lidhur me par.1

nenpar.1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.04/L-082 (KPRK), dhe veprës penale

Sulmi nga neni 184 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par 1 te Kodit Penal te Republikës së Kosovës

,duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP//II. nr.2623-4/21 , të

datës 27.01.2022 në seancën publike të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 30.03.2022, në

praninë e Prokurorit të Shtetit Labinot Jetishi, të pandehurit A.I., të dëmtuarës F.H. , më datë

30.03.2022 mori dhe përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri A.I. i lindur më me numër i biri i H.I. dhe nënës A.I. me vendbanim në Prizren, Rr. ka te kryer shkollën e mesme,i martuar babe i 4 femijëve, i pa pune, i gjendjes se dobët ekonomike shqiptar shtetas i R. te Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

I. Me datë 30.12.2021, rreth orës 17:00 min, në Prizren, në rrugën “Sami Koka” nr. 34, në shtëpinë e përbashkët familjare, me dashje kryen dhunën ose keqtrajtimin fizik dhe psikologjik apo emocional, me qëllim të cenimit të dinjitetit të të dëmtuarit – Trimlind Imeraj – djalit të tij, në atë mënyrë që deri sa i dëmtuari me vëllain e vogël ishte duke lozur para shtëpisë, një person i moshës 30 vjeçare e kishte pyetur se ku e ka shtëpinë N. dhe në atë moment ka dal këtu i pandehuri duke i thënë “çka je duke bërë aty” dhe fillon ta godet me shuplaka në fytyrë, grushta në kokë, me çka i dëmtuari Trimlind pëson ndrydhje dhe mavijosje në laprën e veshit të djathtë, si dhe ndrydhje në anën e djathtë të fytyrës dhe në abdomen, me besueshmëri të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë dhe të mprehtë, që si të tilla bëjnë pjesë në lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, sipas akt ekspertizës mjeko-ligjore të Dr. M.G. dt.22.01.2021.

- këso dore ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nënpar. 3.1 lidhur me par.1 nënpar. 1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

II. Me datë, kohë dhe vend të njëjtë, si pasojë e rrethanave të krijuara si në dispozitivin nën I, të kësaj Aktakuze, me dashje përdorë forcën ndaj personit tjetër – bashkëshortes së tij F. H. në atë mënyrë që në momentin kur hyn në shtëpi i pandehuri duke e rrahur djalin e tij, e dëmtuara ndërhyrë duke i thënë “çka ki me djalin merre vesh mirë punën, mos e rreh palidhje për hallk”, në atë moment i pandehuri i kthehet me fjalët “mshela ti kurv” dhe e godet me boks në veshin e djathtë dhe në gjoks, por e njëjta ka refuzuar ti jepet ndihma mjekësore.

- këso dore ka kryer veprën penale Sulmi nga neni 184 par.3 nënpar. 3.1 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69, dhe 76 te KP te akuzuarit ia shqipton:

DËNIM ME BURG

Per veprën penale nen I te dispozitivit te aktakuzës , ne kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj, kurse për veprën penale nen II te aktakuzës ne kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj.

Te akuzuarit i shqiptohet

DENIMI UNIK ME BURG

Ne kohëzgjatje prej 5 (pese) muaj , ne te cilin i llogaritet koha e kaluar ne ndalim dhe paraburgim prej dt. 31.12.2021 deri me dt. 31.01. 2022.

Për pjesën e mbetur te dënimit bazuar ne nenin 44 te KP dënimi i shqiptuar me burgim i zëvendësohet me dënim me gjobe me pëlqimin e personit te dënuar dhe të njëjtit i shqiptohet gjoba në shume prej 400 euro, të cilën është i obliguar ta paguaj me këste nga 100 euro për çdo muaj, duke filluar në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë .

Te dëmtuarit T.I. dhe F.I. qe te dyte nga Prizreni me banim ne rr.Sami Koka nr. 34, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen ne kontest te rregullt civil.

Obligohet i pandehuri qe ti paguaj te gjitha shpenzimet e procedurës penale sa ato bëhen ne baze te llogarisë se gjykatës, ne emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumen prej 20 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nën kërcenim të ekzekutimit të dhunshëm.

Ne zbatim të ligjit mbi mbrojtjen e viktimave të krimit të akuzuarit i caktohet taksa në shume prej nga 30 euro të cilën është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, ka paraqitur aktakuzën ,PP//II.nr.2623-4/21 te datës 27.01.2022 ndaj te akuzuarit A.I. nga Prizreni ,për shkak te veprave penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së dhe veprës penale Sulmi nga neni 184 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 të Kodit Penal te Republikës së Kosovës Nr.04/L-082 (KPRK).

I pandehuri A.I. ne shqyrtimin fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për pikat e aktakuzës te cilat i vihen ne barrë.

Prokurori i shtetit nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, dhe se i njëjti thekson se me vet pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, i cili pranim ka mbështetje të plotë në provat dhe materialet të cilat i përmban aktakuza dhe po ashtu është në pajtim te plote me nenin 248 te KPP-së, është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës, dhe se në veprimet e të pandehurit formohen te gjitha elementet e veprës penale për të cilën e ngarkon aktakuza .

Andaj kërkoj nga gjykata qe te pandehurit të i shqiptoj dënim meritator sipas dispozitave ligjore.

Kjo gjykatë gjeti se në veprimet e të akuzuarit , plotësohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale: Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 nënpar .1.4 te KPRK-së, andaj i shqiptoi dënimin me burg në kohëzgjatje prej 4 muaj.

Po ashtu gjykata gjeti se në veprimet e te akuzuarit plotësohen edhe elementet qenësore te vepres penale Sulmi nga neni 184 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par .1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës,prandaj gjykata ia shqiptoi dënimin me burg në kohëzgjatje prej 2 muaj.

Gjykat konform nenit 80 të KPRK-së te akuzuarit i shqipton dënimin unik me burg në kohëzgjatje prej 5(pese) muaj ,në të cilin i llogaritet koha e kaluar ne ndalim dhe paraburgim prej datës.31.12.2021 deri me datë 31.01.2022.

Konform nenit 44 te KPRK-së gjykata, me pëlqimin e të dënuarit ia zëvendëson dënimin me burg ne dënim me gjobë në shumë prej 400 euro ,të cilin është i obliguar ta paguaj me këste për çdo muaj, duke filluar në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë.

Gjykata çmoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit.

Si rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti, kurse si rrethana lehtësuese çmoi pranimin e fajësisë gjatë shqyrtimit fillestar, pendimin e thellë nga i pandehuri për veprat e kryera dhe premtimin e tij se në të ardhmen nuk do te kryej vepra te tilla, sjelljen e tij korrekte gjatë gjykimit, faktin se është mbajtës i vetëm i familjes dhe gjendjen e dobët ekonomiko-financiare.

Nga arsyet e cekura gjykata ka shqiptuar dënimin e cekur me larte me bindjen se i përgjigjet shkalles së përgjegjësisë penale të të pandehurit, rrezikshmërisë reale shoqërore të veprës penale, me bindjen se dënimi do te shërbejë si preventive dhe do te parandaloje kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Vendimi mbi udhëzimin juridik ne kontest te rregullt civil është marrë në kuptim të nenit 463 par.2 i KPPK-së.

Më sa u tha më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2022:000210, 30.03.2022

G j y q t a r i

Refki Piraj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimin të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.